

## **STATUTI**

**I**

### **SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

## **"Lotus Technologies"**

- Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 'Per Tregtarët dhe Shoqerite tregtare';

- "Statuti" është ky statut i shoqerisë;

### **Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia, Vula e Shoqerise**

#### **Neni 1;**

**Data e themelimit , Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, me (data e nënshkrimit të këtij Statuti), unë/ne themeluesi/themeluesit, kemi ri-organizuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Lotus Technologies" SH.P.K. Me pare e qajtur "Dollar Deals Gadgets" - themeluar me 08.11.2018.

(2) Themeluesit e shoqerise jane;

-Albert Martini, me dtl. 30.03.1999, me shtetesi Malazeze dhe numer personal 3003999272010, banues i perhershem ne Martinovice bb, Gusinje, 84326, Mali i Zi (Montenegro).

#### **Neni 2;**

#### **Objekti**

Aktivitete te ndryshme programimi, dizajni dhe marketingu si dhe sherbime te tjera që lidhen ngushtë me fushen e informatikes dhe telekomunikacionit.

#### **Neni 3;**

#### **Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e shoqerise nuk është e percaktuar.

#### **Neni 4;**

##### **Selia**

4.1 Selia qendrore e shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Brigada 8, pallati TeknoProjekt, Hyrja 2, Ap 1, 1019, Tirane, Shqiperi

4.2 Adresa e faqes së internetit te shoqerise: [www.lotustechnologies.al](http://www.lotustechnologies.al)

4.3 Adresat e shoqerisë per qellime komunikimi elektronik jane si me poshte;

info@lotustechnologies.al

hi@lotustechnologies.al

hello@lotustechnologies.al

#### **Neni 5;**

##### **Vula e shoqerise**

5.1 Shoqeria do te kete vulen e saj duke shenuar ne te emertimin tregtar, iniciale ose logon.

## **Kreu II**

##### **Kapitali**

#### **Neni 6;**

##### **Kapitali themeltar**

6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 30,000 mije Leke, i zoteruar nga ortakët si me poshte.

6.2 Ortaku themelues **Albert Martini** eshte zoterues i 1 (një) kuote me vlere te pergjithshme 30,000 Leke qe përben 100 % te kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 7;**

##### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund to zmadhohet nepermjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me anë të kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyrojë nje ortak per te rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar te shoqërise

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim ne të njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne të gjitha rastet zvoglimi i prek ortakët ne të njëjtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqësojne.

**Neni 8;**

#### **Transferimi I kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjsi te kufizuar e të drejtat qe rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit na kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimisë;
- c) dhurimit;
- d) cdo mënyre tjeter te parashikuar me ligj.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 9;**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte përgjegjëse per marrjen e vendimeve per shoqërine per çeshtjet e mëposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqërise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratorve;

- ç) emrimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te këtij neni;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve të ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- c) zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- p) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çështje të tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqsohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te: nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te: jepet vetem per nje mledhje te asambles se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 10;**

##### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

10.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi nepermjet postës elektronike, shkrese apo mesazh. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite para mbledhjes se asamblese me perjashtim qe ajo ndodh pa pritur ose esht urgjente.

10.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 të ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisb.

#### **Neni 11;**

##### **Kuorumi**

Në rastin e manjes se vendimeve, që kërkojnë nje shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime te vlefshme vetëm nese marrin pjesë ortakët me te drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 30 per qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit" Per Tregtaret dhe Shoqerite

Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshine vetëm, nese ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total te votave, jane te pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e pergjithshme nuk mund të mbliidhet per shkak te mungesës se kuorumit të përmendur më lartë, asambleja mbliidhet persëri jo me vonë se 30 dite, me të njejtin rend dite.

#### **Neni 12;**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me lli të katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarrës, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimive, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakve pjesëmarrës, per ceshtje te jera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorve;
- c) emëthnin e shkarkiznin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabl te autorizuar;
- c) percaktimin e shpërblimeve
- d) mblkqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratore, perfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedünet e tjera ndaj administratorve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve te asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 13;**

##### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

13.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nëse asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi në ngarkim te tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhëniën ose jo të perfitimeve te reja.

2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vlerohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin përfaqeson.

**Neni 14;**

#### **Administrimi**

14.1 Personi i mëposhtem caktohet si administrator i shoqërisë nga Asambleja e Përgjithshme.

- z. Albert Martini, i biri i Baliut, me dtl. 30.03.1999, me shtetësi Malazeze dhe numer personal 3003999272010, banues i përhershëm në Martinovce bb, Gusinje, 84326, Mali i Zi (Montenegro). Afati i emerimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje

14.2 Asambleja e përgjithshme emerion një ose me shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emerimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

**Neni 15;**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

Administratori/administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndajen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

C) kryejnë detyra të tjera të percaktuara më ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të theksin Asamblesë e Përgjithshme, në rastet kur

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon te shese apo te disponojë ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me të lartë se 5 per qind të aseteve të shoqërisë, qe rezulton në pasqyrat e fluidit financiare te certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga nje ortak pasuri, qe kane vlerë me të lartë se 5% (perqind) të aseteve të shoqërisë, qe rezulton më pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nese asambleja e përgjithshine emëron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, qe bëhen me shpërblimin e administratorit, ne baze të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 16;**

##### **Pergjegjesite e Adminlstratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualislit, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkeljet e ligjeve, per shkelje te statutit, apo për faje te layers, gjatë administrimit te shoqërise.

Pasojat e manëveshjeve të pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dëmë shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka marrëveshjen, per te përballuar ne mënyre individuale ose solidarisht sipas rastit me pasojat përkatëse.

Përvec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te Ligj it "Per Tregtaret dhe Shoqente Tregtare", adminstratori detyrohet:

16.1. a) të kryejë detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe në statut më mirëbesim e në interesin me të mire të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat qe i njihen më ligj dhe në statut vetem per am4jen e qëllimeve të percaktuara në keto dispozita;

c) të vlerësojë me pergjegjesi ceshtjet, për te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personaië me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet në mënyrë te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshperblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregulita. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga me shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshperblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividenda;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimarinë tregtare, kur, në baza të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padise për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin më rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës, me përjashtim se administratori i pare është akoma aksioner i vetëm.

## **Kreu IV**

**Neni 17;**

**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 18;**

**Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushuruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë l'ugarkuar nga ana e ortakëve.



Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per kontrollet periodike te ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

## **Kreu V**

### **Prishja —riorganizimi i shoqërlse**

#### **Neni 19;**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndaria ose prishja e shoqerise mund te bëhët në cdo kohe:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim te Asamblese së Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

c) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarise ne përputhje me piken 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 3.5.2007 'Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast ortaket marrin vendimin me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### **Neni 20;**

#### **Riorganizimi i shoqerise bashkim-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**Neni 21;**

**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 22;**

**Mosmarrveshjet**

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te lindi midis shoqerise apo te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Themeluesi i SHOQERISE ME PERGJITHESI TE KUFIZUAR

**Lotus Technologies**

Albert Mustini



me datë: 15.02.2021

Tiranë, Republika e Shqiperisë